

D H O M A A M E R I K A N E E T R E G E T I S E



A M E R I C A N C H A M B E R O F C O M M E R C E

RAPORT

mbi

problemet në lidhje me çështjet tatimore

dhe

disa propozime për ndryshime në legjislacionin tatimor

Dhjetor 2013

PËRMBAJTJA

HYRJE

- I.** PROBLEME TE HASURA NE LIDHJE ME ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TATIMOR
- II.** KOMUNIKIMI NDERINSTTUCIONAL
- IV.** CESHTJE TE LIDHURA ME FORMIMIN PROFESIONAL DHE ETIKEN
- V.** PROPOZIME PER NDRYSHIME NE LEGJISLACION

HYRJE

Komiteti i Taksave dhe Ligjeve të Dhomës Amerikane të Tregtisë ("AmCham") ka përgatitur këtë Raport Permbledhes te problemeve dhe sygjerimeve te anetareve ("Raporti"). Problemet e shtjelluara më poshtë janë fryt i një komunikimi të brendshëm me të gjithë anëtarët e AmCham të cilet ushtrojnë veprimtarine e tyre tregtare në Shqipëri, vijnë nga industri te ndryshme, dhe nga sipërmarrje te madhesive te ndryshme, si dhe jane fryt i diskutimit te brendshem te anetareve te Komitetit te Taksave dhe Ligjeve te AmCham, dhe i diskutimeve gjate Forumit te Anetareve te AmCham me DPT te mbajtur me date 6 Nentor 2013.

Raporti është konceptuar në mënyrë të tillë që të përmbledhë një gamë të gjerë problemesh të cilat janë te perbashketa per shumicen e anetareve te AmCham, por edhe te trajtoje shqetesime specifike te cilat jane te tilla per shkak te industrise perkatese apo madhesise perkatese te sipermarrjes se anetarit te AmCham.

Raporti është ndarë në katër kapituj kryesore të cilat lidhen me **(A)** zbatimin e legjislacionit tatimor, **(B)** marrëdhëniet nderinstitucionale, **(C)** formimin profesional dhe etiken, si dhe **(D)** konstatime dhe propozime ne lidhje me ndryshime të legjislacionit tatimor.

Problemet ne kete Raport jane pershkruar jo me shume hollesi pasi qellimi ka qene evidentimi i tyre, por ne rast te marrjes parasysh te ketyre problemeve nga strukturat perkatese shteterore, AmCham eshte i gatshem te jape me shume hollesi mbi problemin dhe rekomandime per zgjidhjet e mundshme.

I. PROBLEME TE HASURA

A. Probleme të lidhura me zbatimin e legjislacionit tatimor

Anetaret e AmCham janë shprehur në lidhje me problemet që ata hasin në praktiken e përditshme në lidhje me çështjet tatimore. Me poshtë do të gjeni të rradhitura këto probleme të cilat janë renditur sipas kriterit të rëndësise që paraqesin për anetaret e AmCham:

- Mosrealizimi i rimbursimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH-së) në shkelje të plotë të kushteve dhe procedurave të parashikuara nga Ligji nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar¹ si dhe Udhëzimi nr. 17, datë 13.05.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar². Për më tepër, procesi i rimbursimit është selektiv, ka abuzime me kontrollet tatimore dhe afatet e kryerjes së këtyre kontrolleve të cilat bëjnë konfirmimin e TVSH-se për të rimbursuar. Më tej, problemi është edhe mosllogaritja nga sistemi elektronik dhe nga organet përkatëse tatimore të kamatvonesave përkatëse për vonesa në rimbursimit të TVSH. Një shqetësim tjetër ka të bëjë me mosrimbursimin e eksportuesve sipas legjislacionit në fuqi i cili duhet të jetë i pershpejtuar; në praktike afatet dhe procedurat zgjaten pa arsye ligjore.
- Ushtrimi i rikontrolleve tatimore të përsëritura për të njëjtin detyrim tatimor dhe të njëjtën periudhë tatimore pa arsye, dhe në shkelje të plotë të nenit 85 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar.
- Abuzime nga administrata tatimore gjatë kontrolleve tatimore me rivlerësimin e çmimeve të shitjes (duke iu referuar përlogaritjeve të kostos të cilat janë shpeshherë në kundërshtim me parimet kontabel në vend të çmimeve të tregut), në kundërshtim të plotë me nenet 70, 72 dhe 73 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar.
- Moszbatimi i ligjit për TVSH-ne në rastet e nxjerrjes së mallrave jashtë përdorimit. Inspektoret tatimore kundërshtojnë të nënshkruajnë proces-verbalet për nxjerrjet jashtë përdorimit të mallrave duke kërkuar leshimin e fatures tatimore me TVSH për vlerën e mallrave (pra, duke kërkuar pa të drejtë korrigjimin e kreditimit të TVSH).
- Penalizimi i tatimpaguesve duke mosnjohur fshirjen e borxhit të keq edhe pas provizionimit të plotë të llogarive të arketueshme dhe konsiderimi i fshirjes së këtyre borxheve si kusht i plotësuar për fillimin e procedurave të falimentimit (me efekt ky efekt ka që në tek tatimpaguesit e sistemit financiar). Kjo qasje me këto çështje ka sjelle që shumë tatimpagues të mos bëjnë

¹ Neni 50 i Ligjit “Për TVSH-në”;

² Pika 20 e Udhëzimit “Për TVSH-në”;

fshirje/deklarime te borxheve te keqija duke rezultuar ne pasqyra financiare qe nuk reflektojne sakte realitetin financiar.

- Nje tjetër problem ne industrine financiare eshte edhe interpretimi i kryer nga administrata tatimore i ndryshimit te bere ne nenin 25 te ligjit per tatimin mbi te ardhurat. Pas ndryshimit te kryer ne kete nen, gjate kontrolleve ne industrine financiare inspektoret tatimore kane konsideruar si te ardhur te tatueshme per efekt te llogaritjes se tatim fitimit te periudhes fiskale diferencen midis fondit te provigjonit te krijuar para ndryshimit ligjor (i krijuar ne perputhje me rregulloret e Bankes se Shqiperise deri ne vitin para se te ndodhte ndryshimi ne perputhje me nenin 25 ne fuqi) dhe fondit te krijuar ne vitin perkates 2011 (sipas SNRF-ve dhe te certifikuara pa verejtje nga auditoret e jashtem ne perputhje me nenin e ndryshuar 25), duke i dhene ne kete menyre fuqi prapavepruese ketij neni dhe duke shtrire efektet e tij qe ne fillimet e aktivitetit secilit operator ne kete industri.
- Përcaktimi në mënyrë arbitrare i kësteve mujore të parapagimeve të tatimit mbi fitimin në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.
- Moskompensimi i detyrimeve te paguara me teper me detyrimet e ardhshme tatimore per t’u paguar me justifikimin se nuk eshte konfirmuar ende shuma per shkak se nuk eshte kryer kontrolli tatimor. Moskompensimi i te gjitha llojeve te detyrimeve tatimore per t'u paguar me te gjitha llojet e detyrimeve tatimore te paguara me teper (perfshire TVSH dhe kontributet e sigurimeve) sic percaktohet ne Ligjin nr. 9920.
- *Mosnjohja e TVSH-se se reklamave dhe marketingut*: Industria e telekomunikacionit ngre shqetesimin e mosnjohjes se kreditimit te TVSH per aktivitetet e marketingut dhe reklames. Kuadri ligjor ne fuqi parashikon vetem moskreditimin e TVSH per artikujt publicitare e promocionale (termi “artikull publicitar” perkufizohet ne piken 7.2 te Udhezimit “Per TVSH” si artikull me vlere te vogel per njesi dhe qe publikon nje logo a emer te personit te tatueshem”; sipas Udhezimit, ky trajtim lidhet me faktin se artikujt publicitare dhe promocionale shperndahen falas dhe nuk kane vlere te rendesishme per njesi). Autoritetet tatimore duke devijuar nga fryma e ligjit te TVSH, i interpretojne te gjitha llojet e sherbimit te mirefillte te marketingut si sherbime promocionale duke mos lejuar kreditimin e TVSH.
- Tezgjatja e paaresyeshme e kontrolleve tatimore ne kundërshtim me programet perkatese te kontrollit tatimor dhe afatet dhe procedurat perkatese ligjore.
- Moszbatimi i dispozitave te Kodit te Procedurave Administrative dhe i legjislacionit tjetër perkates nga autoritetet tatimore, perfshire edhe Drejtorine e Apelimit Tatimor.

- Mungesa e transparencës në lidhje me vendimet e Drejtorisë së Apelit të Tatimit dhe vendimet teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; për raste të ngjashme jepën zgjidhje të ndryshme duke shkelur parimin e konkurrencës së drejte. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk shprehet për kërkesat specifike që paraqesin tatimpaguesit dhe në përgjigjet e këtij institucioni nuk gjen zgjidhje mbi themelin e kërkesave perkatëse, por kryesisht citohen vetëm dispozita ligjore duke e lënë cështjen të pazgjidhur dhe duke krijuar pasiguri për tatimpaguesit. Problemet e dala gjatë kontrolleve tatimore si dhe vendimet e apelit të tatimit nuk janë publikuar dhe evidentuar në mënyrë që të propozohen dhe përcaktohen qartë rregullat për të ardhmen.
- Moszbatimi i parimit të mirebesimit në raport me tatimpaguesit; kontrollet tatimore kanë kryesisht rol penalizues dhe jo ndihmues/keshillues sic përcaktojnë parimet e përgjithshme të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar.
- Tejzgjatje e paarsyeshme dhe e paligjshme e procedurave të likuidimit të subjekteve tregtare për shkak të shtyrjes së paarsyeshme në kohë të kontrolleve perkatëse që duhet të kryejnë organet tatimore. Sipas ligjit kontrollet tatimore nuk janë të detyrueshme.
- Mospranimi i cregjistrimit nga QKR për shkak të deklaratave tatimore të viteve 2003-2008 të pavlerësuar në sistemin informatik të administratës tatimore. Organet tatimore nuk duhet të leshojnë vertetime për detyrime të periudhave që janë të amnistuara.
- Të ndalohet praktika e përcaktimit të detyrimeve tatimore mbi bazën e zgjidhjeve ligjore që çojnë në pagesa më të larta të detyrimeve tatimore; organet tatimore për qëllime të detyrimeve tatimore të tatimpaguesit duhet që respektojnë lirinë kontraktore të tatimpaguesit.
- Në Drejtorinë Rajonale Tatimore duhet përmirësuar mundësia e komunikimit të drejtperdrejte me specialistë për probleme apo nevojë që mund të kenë subjektet për të marrë informacion dhe/ose qartësime³.
- *Trajtimi i pedagogëve të jashtëm si persona me kontratë pune:* Universitetet i hartojnë kontratat me pedagogët e jashtëm sipas legjislacionit në fuqi, mbi bazën e marrëdhënies së shërbimit. Pagesat realizohen nëpërmjet bankës dhe për shumën e shërbimit mbahet 10% tatim në burim shumë e cila paguhet pranë organeve tatimore. Kjo është një praktikë e shumë viteve dhe që është zbatuar si e tillë si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Nga kontrollet e fundit është kërkuar që trajtimi i pedagogëve të jashtëm të bëhet me kontratë punësimi dhe për të paguhet edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Zakonisht pedagogët e jashtëm punojnë për periudha të shkurtra dhe kryesisht pa kaluar 40 orë mesimdhënie në muaj. Sugjerojmë që të përcaktohen rregulla të qarta

³ Në këtë mënyrë janë shkelur të drejtat e tatimpaguesve për informim dhe asistencë të parashikuara nga nenet 30 dhe 34 të Ligjit "Për procedurat tatimore"

lidhur me kushtet/rastet kur aplikohet kontrata e shërbimit (subjekt i tatimit në burim) kundrejt marrëdhënies së punësimit.

- *Rivlerësimi i kontributeve për anëtarët e bordit dhe të tjerë:* VKM nr 1114 date 30.07.2008⁴, i ndryshuar, përcakton që pronarët e personave juridikë, që ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri, si administratorë apo çdo funksion tjetër si të punësuar pranë shoqërisë, sigurohen në mënyrë të detyrueshme për sëmundje, barrëlindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale, papunësinë dhe sigurim shëndetësor. Kontrollët tatimore interpretojnë që të gjithë përfaqësuesit ligjorë apo anëtarë të bordit drejtues të shoqërive të huaja apo zyra të përfaqësimit duhet të jenë në skemën e sigurimeve të detyrueshme, duke ngarkuar subjektet perkatese me detyrime, gjoha e kamatvonesa të konsiderueshme, pavarësisht se këta persona nuk kanë një marrëdhënie punësimi me shoqërinë apo zyrën e përfaqësimit, por mund të marrin vetëm honorare për pjesëmarrjet e tyre të cilat në bazë të ligjit për tatimin mbi të ardhurat taten vetëm me 10% tatim mbi të ardhurat, madje në shumë raste, këta persona nuk marrin fare pagese nga shoqëria.
- *Procedurat e zbatimit të marrëveshjeve të menjanimit të taksimit të dyfishtë:* Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjeve Tatimore. DPT përcakton procedurat e zbatimit të këtyre marrëveshjeve. Si pjesë e këtyre procedurave janë formularët që vërtetojnë rezidencën e tatimpaguesve Shqiptarë, si dhe formularët e aplikimit të Marrëveshjes Tatimore. Në shumë raste, përgjigja e DPT është evazive dhe e delegon, në kundërshtim me ligjin, të drejtën për zbatimin e marrëveshjes inspektorit të kontrollit tatimor. Gjithshtu, kemi konstatuar raste kur biznesi ka ndjekur të gjitha procedurat për zbatimin e marrëveshjeve bilaterale për menjanimin e taksimit të dyfishtë duke marrë dhe një përgjigje pozitive nga DPT, por nga ana e kontrolleve tatimore, biznesi është penalizuar me detyrime për tatimin në burim dhe gjoha e kamatvonesa të lidhura me të, pa marrë parasysh dhe pa zbatuar dispozitat e Marrëveshjeve perkatese të menjanimit të tatimit të dyfishtë dhe konfirmimin nga DPT.
- Administrata tatimore duhet të punojë për të luftuar informalitetin i cili cenon jo vetëm buxhetin e shtetit, por edhe parimet e konkurrencës së ndershme për tatimpaguesit e rregullt, qoftë duke identifikuar bizneset e paregjistruara ashtu edhe shitjet pa fatura tatimore, kasa fiskale, etj. Të publikohen informacione lidhur me rastet e evazionit dhe informalitetit por edhe lidhur me tatimpagues të rregullt, duke i promovuar këta të fundit dhe duke mos i penguar nepermjet “vizitave fiskale” apo kontrolleve të panevojshme. Të aktivizohen/forcohen shërbimet on-line duke kërkuar bashkëpunimin e tatimpaguesve dhe shoqërisë civile në luftimin e informalitetit dhe evazionit.

⁴ Nën-pika "ç" e pikës 1

- Te zbatohet e drejta e tatimpaguesit ne lidhje me saktësimin e faturave tatimore per sa i perket zbritjeve tregtare te akorduara nga furnitore te huaj per mallra te importuara para aplikimit te ketyre zbritjeve.
- Te permiresohet cilesia e funksionimit te sistemit elektronik te deklarimit online te tatimpaguesit.
- Te permiresohet dhe te aplikohet analiza e riskut ne menyre qe zbatimi i kontrolleve tatimore, etj., te kryhet ne menyre te drejte dhe ligjore per te gjithë kategorite e tatimpaguesve. Zgjedhja e tatimpaguesve për kontroll bazuar në analizën e riskut nuk ka dhënë në praktikë rezultatin e synuar nga Ligji. Sipas pervojes sonë janë zgjedhur për kontroll me shumë tatimpaguesit e mëdhenj me nivel mjaft të mirë të përmbushjes së detyrimeve tatimore. Pra, duhen rishikuar kriteret e zgjedhjes. Gjithashtu, sistemi që përdoret ka lënë jashtë analizës së riskut të zgjedhjes për kontroll tatimor personat të peregjistruar dhe tatimpaguesit e biznesit të vogël me xhiro formale vjetore nën 8 milionë lekë.
- Rezultatet (gjetjet) e kontrolleve tatimore dhe rastet e shumta që mbeten me vite në procese apelimi në gjykata kanë treguar se gjetjet, zbulimet dhe gjobat e aplikuara kanë qenë në shumë raste në kundërshtim me thelbin e ligjit, dhe kanë patur synim realizimin momental të planit (për shkak të detyrimit për parapagimin e detyrimeve para apelimit), dhe kanë krijuar kosto shtesë administrative dhe financiare si për tatimpaguesit ashtu edhe për administratën tatimore.
- Në shumë raste gjate kontrolleve tatimore nuk është bërë ndarja e gabimeve formale apo administrative pa dem financiar në detyrimet tatimore nga shkeljet apo gabimet me dem financiar në pagimin e tatimeve. Ligji parashikon gjoba fikse administrative për gabimet e përmendura në fillim, por raport kontrollet kanë penalizuar me detyrime, interesa dhe gjoba edhe shkelje apo gabime qe nuk kanë patur efekt negativ fiskal për autoritetin tatimor.
- Te forcohen funksionet drejtorive/sectorëve të shërbimit të tatimpaguesve duke parë mundësinë edhe të bashkimit me sektorët e vlerësimit (përpunimit) në mënyrë që ti shërbehet tatimpaguesve në mënyrë eficente lidhur me regjistrimet, cregjistrimet, përpunimin e deklaratave dhe kryerjen e kompensimeve.
- Ne lidhje me rivleresimin e cmimeve te shitjes, jane konstatuar raste te penalizimit te tatimpaguesit për TVSH-ne dhe tatim fitimin, si dhe gjobat perkatese me argumentin se tatimpaguesi nuk ka paguar detyrimet tatimore mbi bazen e çmimet e mallrave ne castin qe i shiten klientit final, por mbi bazen e çmimeve te mallrave te shitura te distributoret. Duke qene se çmimet e reja te aplikuara kane rezultuar me te larta se ato fillestare, nderkohe qe distributoret kane shitur mallrat me kete çmim me te larte duke siguruar ne ketë mënyre një fitim nga shitja, tatimpaguesi (furnizues i distributorit) eshte konsideruar te mos kete përmbushur detyrimin e tij për te leshuar një fature

shtese per diferencën midis çmimit te shitur te distributori dhe çmimit te pakices te mëpasshëm. Ligji nuk parashikon ne menyre te shprehur ose nenkuptuar ndonjë detyrim tatimor si pasoje e rritjes së çmimit të shitjes me pakicë. Sipas Kushtetutes se Shqiperise askush (perfshire edhe personat juridike) nuk mund te ngarkohet me detyrime tatimore nese ligji nuk parashikon shprehimisht per keto detyrime tatimore. Ky shqetesim vjen nga industria e cigareve.

B. KOMUNIKIMI NDERINSTITUCIONAL

Anetaret e AmCham kane shprehur edhe ate cfare ata kane identifikuar ne lidhje me komunikimin nderistitucional i cili sjell probleme te praktikës se perdritshme me natyre tatimore. Me tej, jane shprehur edhe konstatime ne lidhje me etiken profesionale dhe personale te punonjesve te administratave perkatese:

- Verehet mungesë koordinimi dhe komunikimi mes institucionit qendror QKR i ngritur për krijimin dhe çregjistrimin, dhe qellime te likujdimin, etj., te subjekteve tregtare me Drejtoritë perkatese Tatimore si edhe me drejtoritë/zyrat e taksave lokale në bashki e komuna.
- Verehet mungese komunikimi dhe koordinimi midis organeve tatimore dhe atyre doganore per qellime te rakordimit te te dhenave nga sistemet doganore dhe tatimore per qellime te detyrimeve tatimore, etj.
- Te rritet shkalla e konsiderimit te rekomandimeve te Avokatit te Tatimpaguesve nga administrata tatimore.
- Te rritet niveli i bashkepunimit midis Avokatit te Tatimpaguesve dhe Avokatit te Popullit per qellime te nderhyrjeve efektive ne interes te tatimpaguesve te te gjitha niveleve.
- Tashme ka nje proces gjyqesor te nisur midis institucionit te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve dhe atij te Kontrollit te Larte te Shtetit ('KLSH') ne lidhje me te drejten e inspektoreve te KLSH per te kontrolluar subjektet tregtare per qellime te detyrimeve tatimore; sipas ligjit tatimpaguesit private duhet te jene vetem subjekt i kontrolleve tatimore te kryera nga organet tatimore perkatese.
- Te rritet bashkepunimi midis strukturave te administrates tatimore dhe strukturave te Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise, me qellim uljen e abuzimeve nga tatimpaguesit jo te rregullt te industrive relevante.

- Te rritet bashkepunimi midis DPT dhe Drejtorise se Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave me qellim uljen e informalitetit dhe futjen ne rregulla te drejta konkurrence dhe ligjore te te gjitha tatimpaguesve.

C. FORMIMI PROFESIONAL DHE ÇESHTJE LIDHUR ME ETIKEN

Problemet e meposhtme jane raportuar ne lidhje me formimin profesional dhe etiken:

- Inspektorët e Drejtorive Rajonale Tatimore reflektojnë gjatë kontrolleve tatimore mungesë të theksuar të njohurive rreth legjislacionit tatimor të zbatueshëm dhe procedurave të rregullta ligjore. Vërehet një abuzim me kompetencat dhe tendencë për të penalizuar subjektet tatimore pavarësisht perfundimeve reale konkrete të kontrolleve⁵.
- Identifikohet nevoja për trainime profesionale dhe ligjore të punonjesve të administrates tatimore, në veçanti në lidhje me zbatimin e marreveshjeve për shmangjen e taksimit të dyfishtë.
- Përveçse vërehen probleme në lidhje me etiken profesionale, herë herë vërehen edhe probleme në lidhje me etiken personale të inspektoreve të administrates tatimore, përfshirë këtu edhe korrupsionin në rradhet e punonjesve të administrates tatimore, etj.

D. PROPOZIME PËR NDRYSHIME NE LEGJISLACION

Nga anetaret e AmCham ka patur edhe konstatime në lidhje me ndryshimet e deritanishme të legjislacionit tatimor, dhe po kështu ka patur edhe propozime konkrete për ndryshime në legjislacion:

- Ndryshimi i shpejtë i legjislacionit tatimor dhe parashikimi i dispozitave të paqarta të cilave u jepet interpretim jo uniform përbën një problem gjithmonë e më të madh për sigurinë juridike të sipërmarrjeve private. Mungesa e interpretimeve unifikuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ndikon në cënimin e sigurisë juridike.
- Aktet normative nenligjore të Keshillit të Ministrave, Ministrise së Financave, etj., që kanë të bëjnë me legjislacionin tatimor duhet të rishikohen në mënyrë që të jenë në përputhje dhe të mos tejkalojnë dispozitat e parashikuara në ligjet përkatëse të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

⁵ Kjo duke shkelur të drejtën e tatimpaguesve për kontrolle të arsyeshme të parashikuar nga neni 33 i Ligjit “Për procedurat tatimore”;

- Sygjerohet qartësim i metejshëm dhe i shprehur në aktet ligjore në mënyrë që të menjahet mbivendosja e kompetencave të KLSH dhe DPT në lidhje me kontrollin e tatimpaguesve private.
- Legjislacioni tatimor dhe në veçanti Ligji nr. 9920 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, duhet të rishihet që të jetë në përputhje me aktet e tjera normative të cilat qëndrojnë më lart në hierarkinë⁶ e këtyre akteve, të tilla si Kodi Civil, Kodi i Procedurave Civile, etj.
- Sugjerohet ndryshimi i nenit 107⁷ të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, i cili parashikon si kusht për shqyrtimin e Ankimit Administrativ Tatimor, pagesën paraprake të detyrimit tatimor (duke përjashtuar gjokat), është thelbësor për shmangien e abuzivizimit në penalizimin e tatimpaguesve. Propozojmë që pagesa e detyrimit tatimor të jetë e detyrueshme për tu paguar vetëm pas marrjes së një vendimi të formës së prerë nga gjykata
- Parashikimi i lehtësirave fiskale në lidhje me pagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore është një domosdoshmëri. Sugjerohet që të shihet mundësia e reduktimit të nivelit të kontributeve të detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore si për punëmarrësit ashtu edhe për punëdhënësit, duke krijuar më shumë mundësi për sigurimet dhe fondet private të sigurimeve shoqërore (fondet e pensioneve) dhe sigurimeve shëndetsore.
- Neni 59/2⁸ i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, i cili parashikon ndalimin e shitjes me shumicë dhe shitjes me pakicë në të njëjtin mjedis duhet ndryshuar duke i dhënë të drejtën Ministrisë së Financave për të përcaktuar aktivitetet për të cilat kjo dispozitë nuk zbatohet, pasi ky nen nuk është i zbatueshëm për disa aktivitete specifike.
- Zbatimi i rentës minerare për çimenton: Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 7⁹, autoritetet doganore shqiptare e detyruan industrinë e cimentos, të paguajë si rentë minerare për eksportin e cimentos gjatë 2012, shumën 5 % të llogaritur mbi shumën e përgjithshme të faturuar të cimentos së eksportuar. Renta minerare¹⁰ është një taksë që zbatohet për shfrytëzimin e mineraleve në Shqipëri, dhe jo një taksë e aplikuar mbi vlerën e produktit përfundimtar që del nga përpunimi i

⁶ Hierarkine e akteve normative sic përcaktohet në Kushtetutën e Shqipërisë.

⁷ Neni 107 parashikon se "Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimohet, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që, bashkë me ankesën, të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore"

⁸ Neni 59/2 parashikon se "Përveç detyrimeve të tjera, të parashikuara në këtë ligj, tatimpaguesi, në përputhje me legjislacionin tatimor, duhet të reklamohet në vende të dukshme, çmimet e mallrave dhe të shërbimeve që ofron. Në rastet kur ushtron njëkohësisht tregti me shumicë dhe me pakicë, është i detyruar që t'i organizojë këto veprimtari në vende të veçanta, të ndara nga njëri-tjetri".

⁹ Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 04.01.2012 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionin e nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare"

¹⁰ Sipas përkufizimit Ligji "Mbi Taksat Kombëtare"

mineraleve me elementë të tjerë (siç është çimento¹¹). Në këtë rrethana, ky Vendim u hapi rrugë pagesave shtesë të detyrueshme, që iu imponuan kesaj industrie në bazë të një skeme të pajustificuar dhe të jashtëligjshme, duke rritur barrën fiskale me 29 herë për ton çimentoje të eksportuar gjatë periudhës janar-prill 2012. Më tej, në baze të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 201, datë 21.03.2012¹², Grupi i Punës *ad hoc* i Qeverisë, beri ndryshime në koston e mineraleve të përdorura për ton cimento (duke marrë për baze cmime reference), si dhe të normativës përkatëse për perlloraritjen e pjesmarrjes së këtyre mineraleve në procesin e prodhimit. Këto ndryshime paten si rrjedhojë që rritja e rentës minerare të ishte 5 (pese) herë me shumë krahasuar me nivelin e zbatuar në vitin 2011.

- Ndryshimi i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, dhe i akteve të tjera të kësaj lloji, në lidhje me strukturat e Avokatit të Tatimpaguesve dhe Drejtorisë së Apelit Tatimor. Më saktësisht, ndryshimi i varësisë së këtyre strukturave (jo vetëm drejtuesit të tyre por të gjithë stafit) nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tek Ministria e Financave pasi nga këto struktura pritet që të identifikojnë dhe shqyrtojnë ankimet e tatimpaguesve lidhur me veprimtarinë e organeve tatimore.
- Ndryshimi i Ligjit “Për procedurat tatimore”, duke shprehur qartë faktin që gjambat për mosplotësim të saktë të deklaratës tatimore apo gabime të tjera që rezultojnë në pagesë të vonuar të detyrimit tatimor janë 5% për muaj vonesë dhe jo më shumë se 25%, dhe nuk publikohen duke aplikuar edhe gjoba (5 – 25%) për pagesë të vonuar. Organet tatimore aplikojnë dy herë gjobat e mësipërme: një herë si “gjoba sistemi” (për deklarim të gabuar) dhe një herë si “gjoba inspektori” (për pagesë të vonuar).
- Përcaktimi në ligjin e TVSH-se i konceptit të eksportit të shërbimeve dhe procedurave që lidhen me të duhet të kryhet sa më parë në mënyrë që të shmangen paqartësitë dhe zbatimi i gabuar i legjislacionit përkatës tatimor. Shumë shërbime (si psh. shërbime konsulence, teknike, menaxhimi, etj.) kryhen pa qenë nevojë e prezencës fizike në vendin e përfituesit të shërbimit, kështu që duhet të përcaktohet qartë koncepti i “vëndit të konsumit” të shërbimit.
- Të qartësohet në Udhëzim nëse emerimi i përfaqësuesit tatimor për qëllime të TVSH-se kur jepen shërbime në lidhje me pasuritë e paluajtshme është i nevojshëm apo jo në rastet kur ofruesi i

¹¹ Çimento nuk është mineral, ndaj nuk klasifikohet si subjekt i rentës minerare në Ligjin “Mbi Taksat Kombëtare”

¹² Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 201, datë 21.03.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.7, datë 04.01.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionin e nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare” (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 35, datë 17.04.2012)

shërbimit ka një presencë ligjore në Shqipëri (Ministri i Financave nëpërmjet një letre interpretuese e ka qartësuar këtë shqetësim duke shpjeguar që emërimi i përfaqësuesit tatimor nuk është i nevojshëm në këtë rast. Gjithsesi, në mënyrë që të shmangët çdo lloj interpretimi në lidhje me këtë çështje është e këshillueshme që ky qëndrim të vendoset si dispozitë në Udhëzimin që përketes të Ministrisë së Financave.

- Ndryshimi i Ligjit “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” lidhur me caktimin nga personat jo-rezidentë të një Përfaqësuesi Tatimor për TVSH, duke konsideruar faktin se në rastet kur përfituesi i shërbimit është tatimpagues TVSH-je dhe aplikon autofaturimin e TVSH-së (VAT reverse charge) nuk ka nevojë të krijohen kosto shtesë administrative dhe financiare për emërimin e një Përfaqësuesi Tatimor.
- Përjashtimi i shërbimit të sigurimeve, të cilat konsiderohen si shërbime financiare, nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), duhet të bëhet në modelin e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Tashmë, në Shqipëri përjashtohen nga TVSH vetëm shërbimi i sigurimit të jetës¹³.
- Ulja e nivelit të taksave të zbatueshme për koksin e naftës nëpërmjet ndryshimit të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për akcizat”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, është thelbësor për rritjen e konkurrueshmërisë së sipërmarrjeve shqiptare (tashmë, niveli total i akcizës dhe takës së karbonit për koksin e naftës është në nivelin 5 lekë/kg).
- Duhet qartësuar në akte nënligjore trajtimi i firove dhe dëmtimet për qelime tatimore: Neni 12/3, pika k), të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, që përcakton se janë shpenzime të panjohura: “humbjet, dëmtimet, frotet dhe skarcot gjatë prodhimit, tranzitimit dhe magazinimit, të normave të përcaktuara në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore. Nderkohe, nuk ekzistojnë akte nënligjore për përcaktimin e firove në industri të ndryshme duke lënë shkas për abuzime nga ana e inspektorëve tatimore.
- Propozohet hyrja në fuqi e legjislacionit tatimor dhe e çdo ndryshimi me efekt fiskal në fillim të vitit fiskal.
- Të shihet ndryshimi i nivelit të TVSH-se për produkte të ndryshme duke konsideruar shkallen tatimore të vendeve të rajonit në mënyrë që produktet shqiptare të jenë konkurruese (sidomos krahasuar me produktet e vendeve të tilla si Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia të cilat zbatojnë për disa produkte/mallra nivele më të ulëta të TVSH-se).
- Të ndryshohen dispozitat që përketes të legjislacionit në mënyrë që shoqëritë e ndërtimit të mos ngarkohen me detyrime tatimore edhe për shitjet e paralizuar. Si në çdo industri, këto shoqëri

¹³ Neni 21/dh i Ligjit “Për TVSH-në”;

duhet te tatohen vetem per shitjet e realizuara. Po keshtu, te ndryshohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne menyre qe shoqerite e ndertimit te mos ngarkohen edhe me detyrimet tatimore te pronareve te truallit; kjo do te clironte industrine e ndertimit nga nje barre fiskale e padrejte.